

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

28.02.2024

Ora 12:07

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Elvis Jani Hadjdërlli, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Devoll, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaç, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike, kemi në rend dite disa çështje që lidhen me zëvendësimin e vendeve vakante për anëtarë të këshillit bashkiak në disa bashki. Kemi shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për dy subjekte vetëdeklarues, zotin Elvis Hadjdërlli, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Devoll, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Dritan Salkurti, anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Ndërkohë kemi nga seanca e shkuar dhe shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar për zotin Kristian Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

Partia Socialiste e Shqipërisë. Këtë, besoj do ta shtyjme deri sa të marrim përgjigje nga organi i prokurorisë speciale.

Mirë fillojmë sipas rendit të ditës!

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Në zbatim të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për Kryetar Bashkie”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për kryetar në Bashkinë Devoll, Qarku Korçë, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 21282. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se subjekti vetëdeklarues, në rubrikën “Të dhëna personale”, ka deklaruar ndryshimin e emrit të tij, amësisë dhe atësisë si dhe ka deklaruar një dënim nga Gjykata e Selanikut. Gjithashtu ka deklaruar se ka qenë në hetim për të njejtën vepër penale dhe ka deklaruar se ka jetuar më shumë se një muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Ky institucion në datën 15.02.2024 ka sjellë vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Elvis Hajdërlli. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, konstatohet se zoti Elvis Hajdërlli, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Devoll, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk është shpallur fitues dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord! Këtë do ta përfundojmë pa vendim, për shkak se në asnjë rrethanë nuk do të marrë mandat ky subjekt.

Vendimi nr. 22

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

28.02.2024

Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Dritan Emrush Salkurti, anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te rasti tjetër!

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të ligjit 138/2015, Dritan Emrush Salkurti, anëtar në Këshillin e Bashkisë ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 3. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati, në rubrikën “Të dhëna personale”, ka deklaruar ndryshimin e emrit të tij, nga “Olsi” në “Dritan” si dhe ka deklaruar një vendim nga Gjykata e Larisës, në Greqi. Nisur nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Ky institucion në datën 15.02.2024 ka sjellë vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Dritan Salkurti. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të përgjithshëm, konstatohet se zoti Dritan Salkurti, anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, i ka përfunduar mandati i anëtarit të këshillit dhe si rrjedhojë nuk është subjekt i këtij ligji. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord! Edhe për këtë rast do ta mbyllim procedurën e rezultatit të verifikimit pa vendim përfundimtar, për shkak se kandidati në fjalë nuk mund të marrë mandat në asnjë lloj rrethane.

Vendimi nr. 23

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Këshillat e Bashkisë Tiranë, Kukës, Selenicë dhe Kavajë, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve të tyre. Kandidatët vijues nga listat shumëmemërore të partive përkatëse kanë plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për këta kandidatë, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë nga DPGJC ende nuk ka ardhur përgjigje, ndërsa DPGJGJ ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për të katërt kandidatët. Konstatohet se kandidatët nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, Kreu V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.02.2024*

Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive: Tiranë, Kukës, Selenicë dhe Kavajë nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni të katër projektvendimet dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Alfred Muharremi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”, zotin Averdi Syla.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, zotin Idai Veizaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, zonjën Kledja Vishkulli.

Çështje të tjera nuk kemi?! Në rregull, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 24, 25, 26, 27.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

